



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 121, datë 29.08.2012

**MBI SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SHOQËRISË SË
SIGURIMIT SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, dhe neneve 139 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, pasi mori në shqyrtim ankimin e shoqërisë së sigurimit “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a., ndaj pikës 1, të Vendimit të Bordit nr. 89, datë 18.07.2012, me propozim të Departamentit të Çështjeve Ligjore,

K O N S T A T O I S E:

Shoqëria Sigma sh.a me shkresën nr. 882 prot, datë 24.07.2012, ka depozituar në Autoritet kundërshtim në lidhje me sanksionin me gjobë në masën 1,500,000 lekë, sipas Vendimit të Bordit nr 89, datë 18.07.2012.

Pas konkluzioneve të Analizës së Gjendjes Financiare të vitit 2011 dhe 3-mujorit të parë të vitit 2012, ka rezultuar se shoqëria “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a. ka lidhur një kontratë sigurimi nr serie 111/11, me të siguruarin “Hidrogjenin Jugor”, në favor të një enti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në shkelje të nenit 43 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

Shoqëria “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a., ushtron veprimtari sipas formës juridike, degë në territorin e Kosovës.

Në këto kushte kontrata e sigurimit e lidhur me subjektin “Hidrogjenin Jugor”, me mbulim në territorin e Kosovës, duhej të sigurohej vetëm nga dega Kosovë e shoqërisë “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a., e lejuar nga Autoriteti për ushtrim veprimtarie si degë në Kosovë.

Për sa më sipër Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Lënien në fuqi të pikës 1, të Vendimit të Bordit të AMF-së nr. 89, datë 18.07.2012 “Për masat ndaj shoqërisë së sigurimit “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a., nga analiza e vitit 2011 dhe 3 mujori i parë i vitit 2012”, si dhe rrëzimin e ankimit të shoqërisë së sigurimit “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI